

Raport lokal për
rajonin e Pollogut

**GJENDJA E DHUNËS
NË FAMILJE DHE
DHUNËS SEKSUALE
2022 - 2024**

Republika e Maqedonisë së Veriut

Botues:

Qendra për mundësi të barabarta "Mollëkuqja"

Autorë:

Prof.dr Blerta Ahmed, Prof.dr Arta Mero

Përpunimi grafik:

Vigan Demiri

Hulumtues:

Prof.dr Merita Zulfiu-Alili, Prof.dr Vedije Ratkoceri, Mr.sc Ema Murtezani

Ky dokument është punuar në kuadër të projektit "MBROJTJE ME LIGJ: Mbështetje ligjore dhe mbrojtje për viktimat e dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore" i zbatuar nga Qendra për Mundësi të Barabarta "Mollëkuqja", në kuadër të aksionit "Kujdesemi: Së bashku luftojmë kundër dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore," i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i udhëhequr nga Rrjeti nacional kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e Qendrës për mundësi të barabarta "Mollëkuqja", dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se përfaqëson qëndrimet dhe pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Dhjetor, 2025

Përmbajtja

Hyrje	6
Metodologjia	8
Shtirirja dhe qëllimi i raportit	8
1. Qendra ndërkomunale për punë sociale - Gostivar	9
2. Qendra ndërkomunale për punë sociale - Tetovë	10
2.1 Rastet e regjistruara të dhunës në familje në Qendrën ndërkomunale për punë Sociale – Tetovë (2022-2024)	11
2.2 Rastet e regjistruara të dhunës seksuale (2022-2024)	13
3. Gjykata themelore - Tetovë.	14
4. Gjykata themelore - Gostivar	14
5. Qendra për referim të viktimave të dhunës seksuale - Spitali klinik-Tetovë	16
6. Ministria e punëve të brendshme - Sektori për punë të brendshme- Tetovë	17
6.1 Të dhënat për gjendjen e dhunës në familje - Sektori për punë të brendshme- Tetovë (2022-2024)	17
6.2 Veprat penale lidhur me dhunën në familje - viti 2022	20
6.3 Veprat penale lidhur me dhunën në familje - viti 2023	21
6.4 Veprat penale lidhur me dhunën në familje - viti 2024	22
6.5 Të dhënat për gjendjen e dhunës seksuale në Sektorin për punë të brendshme-Tetovë (2022-2024)	23
Përfundime	29
Rekomandimet	32

Hyrje

Në kuadër të aksionit ***“KUJDESEMI: Së bashku kundër dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore”***, të financuar nga Bashkimi evropian dhe i nëngarantuar nga Rrjeti nacional kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, Qendra për mundësi të barabarta “Mollëkuqja” e dhe Klinika juridike “Emine Zendeli” e Fakultetit juridik pranë Universitetit të Evropës juglindore, realizuan këtë analizë me qëllim hartimin e një raporti lokal për dhunën me bazë gjinore, me fokus të veçantë të dhuna seksuale në rajonin planor të Pollogut.

Ky raport paraqet një pasqyrë të gjithanshme të gjendjes së dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje gjatë periudhës 2022-2024, duke i kushtuar vëmendje të posaçme rasteve të dhunës seksuale. Analiza përfshin nëntë komunitet që e përbëjnë rajonin planor të Pollogut: Tetovë, Gostivar, Mavrovë dhe Rostushë, Zhelinë, Tearcë, Bogovinë, Vrapçisht, Jegunovcë dhe Bërvenicë - rajon në të cilin funksionojnë dy Qendra ndërkomunale për punë sociale (në Tetovë dhe Gostivar), dy Gjykata themelore (Tetovë dhe Gostivar) dhe Sektori për punë të brendshme-Tetovë.

Trajtimi juridik i viktimave të dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje dhe dhunës seksuale është i rregulluar me legjislacionin pozitiv të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe me instrumente relevante ndërkombëtare, të cilat përcaktojnë detyrime të qarta për institucionet lidhur me mbrojtjen, ndihmën dhe rehabilitimin e viktimave. Këto mekanizma synojnë të sigurojnë një qasje të sigurt, efikase dhe të specializuar drejt shërbimeve mbështetëse. Për një analizë më të detajuar lidhur me të drejtat e viktimave dhe qasjen institucionale në trajtimin e tyre, ju referojmë raportit të publikuar në maj të vitit 2022 me titull:

“Analizë e gjendjes me shërbimet e specializuara të qasshme dhe të disponueshme për ndihmë dhe mbështetje për gratë dhe fëmijët viktimë të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në rajonin planor të Pollogut (2018-2021)”.¹

¹ „Анализа на состојбата со пристапни и достапни специјализирани сервиси за помош и поддршка на жени и деца жртви на родово базирано и семејно насилство во Полошки плански регион (2018-2021)“ i qasshëm në linkun: <https://glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2022/12/Analiza-MK-Final-od-ANA.pdf>

Qëllimi i këtij raporti është të paraqesë vëllimin, strukturën dhe dinamikën e rasteve të paraqitura, përmes analizës së të dhënave të siguruara nga institucionet relevante publike. Vëmendja e posaçme i kushtohet profileve të viktimave dhe kryerës (gjinia, mosha, përkatësia etnike), formave të dhunës, si dhe natyrës së marrëdhënies mes viktimës dhe kryerës.

Në kuadër të këtij projekti, një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe Klinika Juridike "Emine Zendeli" e Fakultetit juridik pranë Universitetit të Evropës Juglindore, e cila përmes mentoreve profesoreshat Arta Mero dhe Blerta Ahmedi si dhe studentëve ka qenë e përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në ofrimin e ndihmës juridike primare për viktimat e dhunës me bazë gjinore. Studentët e Klinikës juridike, nën mentorimin profesional të mentoreve të tyre, kanë marrë pjesë në ciklin e trajnimeve të posaçme që synojnë forcimin e kapaciteteve të tyre praktike dhe teorike për trajtimin juridik të rasteve të dhunës. Kontributi i Klinikës juridike ka përfshirë jo vetëm këshillimin dhe informimin juridike të viktimave, por edhe shoqërimin e tyre para institucioneve përkatëse, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj përjetimeve traumatike. Ky angazhim ka ndihmuar në rritjen e qasjes së viktimave në drejtësi dhe në forcimin e rolit të studentëve në ofrimin e mbështetjes juridike cilësore në raste të ndjeshme dhe komplekse.

Metodologjia

Raporti është përgatitur mbi bazën e të dhënave të mbledhura përmes kërkesave për qasje në informata me karakter publik, të dërguara në gjashtë institucione. Në analizë janë përfshirë:

- Ministria e punëve të brendshme - Sektori për punë të brendshme- Tetovë
- Qendra ndërkomunale për punë sociale - Tetovë
- Qendra ndërkomunale për punë sociale - Gostivar
- Qendra për referim të viktimave të dhunës seksuale - Spitali klinik i Tetovës
- Gjykata themelore- Tetovë
- Gjykata themelore -Gostivar

Të dhënat janë përpunuar sipas viteve kalendarike dhe janë klasifikuar sipas formës së dhunës (psikologjike, fizike, ekonomike, seksuale), duke dhënë pasqyrë mbi numrin e viktimave dhe kryerësve, si dhe mbi epilogun juridik të rasteve të paraqitura

Shtrirja dhe qëllimi i raportit

Raporti shërben si një mjet për:

- Paraqitjen e gjendjes reale të dhunës në familje dhe dhunës seksuale në rajonin e Pollogut,
- Identifikimin e grupeve në rrezik dhe modeleve të përsëritjes,
- Mbështetjen e hartimit të politikave të synuara dhe parandaluese,
- Nxitjen e një koordinimi më të mirë institucional,
- Zbulimin e mangësive në evidentimin dhe raportimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Përmes mjeteve kuantitative dhe vizuale, raporti vë në pah prioritetet për përmirësimin e mekanizmave mbrojtës dhe nënvizon nevojën për një qasje të integruar në trajtimin e viktimave.

1. Qendra ndërkomunale për punë sociale - Gostivar

Kjo pjesë e raportit paraqet të dhënat e siguruar nga Qendra ndërkomunale për punë sociale - Gostivar, të cilat lidhen me rastet e regjistruara të dhunës në familje gjatë periudhës 2022-2024. Gjatë këtij periudhe trevjeçare, në territorin e mbuluar nga Qendra janë evidentuar gjithsej **92** raste të dhunës në familje.




Tabela 1. Numri i viktimave të regjistruara të dhunës në familje sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike (2022–2024)²

2 Qendra ndërkomunale për punë sociale - Gostivar, Shkurt 2025

Sipas të dhënave, gjatë vitit **2022**, katër viktimë kanë jetuar në bashkësi jashtëmartesore, ndërsa të tjerat në martesë ligjore. Dy viktimë janë strehuar në strehimore për gra viktimë të dhunës në familje. Në vitin **2023**, pesë viktimë kanë jetuar në bashkësi jashtëmartesore, ndërsa të tjerat në martesë ligjore. Dy viktimë janë strehuar në strehimore. Në vitin **2024**, gjashtë viktimë kanë jetuar në bashkësi jashtëmartesore, ndërsa të tjerat në martesë ligjore. Tre viktimë janë strehuar në strehimore për gra viktimë të dhunës në familje.

Në lidhje me dhunën seksuale, gjatë periudhës së analizuar nuk janë evidencuar raste të raportuara, gjë e cila, megjithatë, nuk nënkupton mungesën e fenomenit, por mund të tregojë për një nivel të ulët të raportimit dhe nevojë për forcim të mekanizmave të identifikimit dhe mbështetjes së viktimave.

2. Qendra ndërkomunale për punë sociale - Tetovë

Kjo pjesë e raportit paraqet vëllimin, strukturën dhe karakteristikat e rasteve të raportuara të dhunës në familje dhe dhunës seksuale në territorin e Qendrës ndërkomunale për punë sociale - Tetovë, gjatë periudhës 2022-2024. Analiza përfshin të dhënat mbi gjininë dhe përkatësinë etnike të viktimave, format e dhunës, shërbimet e përdorura, masat e përkohshme të mbrojtjes dhe sistemimin e viktimave në qendra për qëndrim të përkohshëm.

2.1 Rastet e regjistruara të dhunës në familje në Qendrën ndërkomunale për punë Sociale – Tetovë (2022-2024)

2022					
Totali i viktimave	57	Gra	50	Burra	7
				45 Shqiptarë	2 Romë
				10 Maqedonë	
2023					
Totali i viktimave	56	Gra	47	Burra	8
				30 Shqiptarë	4 Romë
				20 Maqedonë	2 të tjerë
2024					
Totali i viktimave	101	Gra	68	Burra	5
				50 Shqiptarë	10 Romë 2 të tjerë
				34 Maqedonë	2 Turq

Tabela 2. Numri i viktimave të regjistruara të dhunës në familje sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike (2022-2024)³

Gjatë periudhës trevjeçare nga viti 2022 deri në vitin 2024, nga gjithsej **214** viktima të regjistruara të dhunës në familje, janë identifikuar **165** viktima gra dhe **20** viktima burra, çka e konfirmon pabarazinë e theksuar gjinore në rastet e raportuara. Në vitin 2022, viktimat gra përbënin **87.7%** të totalit; në vitin 2023 - **85.5%**; ndërsa në vitin 2024, përqindja është rritur në **93.2%**. Ndërkohë, përqindja e viktimave burra ka rënë nga **12.3%** në vitin 2022, në **6.8%** në vitin 2024. Sipas të dhënave, shifra prej **214** viktimash l përfshin si personat madhorë ashtu edhe të mitur, por **nuk është siguruar ndarje e detajuar sipas grupmoshave**, gjë që paraqet kufizim për një analizë më të thelluar të karakteristikave strukturore të viktimave.

2022

Totali i
rasteve **57**Dhunë
psikologjike **57**Dhunë
fizike **30**Dhunë
ekonomike **0**

2023

Totali i
rasteve **56**Dhunë
psikologjike **56**Dhunë
fizike **31**Dhunë
ekonomike **1**

2024

Totali i
rasteve **101**Dhunë
psikologjike **101**Dhunë
fizike **70**Dhunë
ekonomike **1**

Tabela 3. Format e dhunës në familje në Qendrën ndërkomunale për punë Sociale - Tetovë (2022-2024)

Në vitet 2022 dhe 2023, numri i rasteve të dhunës psikologjike ka qenë pothuajse i njëjtë (**57 dhe 56 raste**), ndërsa në vitin 2024 është vërejtur **një rritje e theksuar në 101 raste**, gjë që mund të tregojë raportim më intensiv ose përmirësim të identifikimit institucional.

Në vitin 2022 janë propozuar 34 masa të përkohshme për mbrojtje nga dhuna në familje, prej të cilave 30 janë shqiptuar nga gjykata kompetente.

Në vitin 2023 vërehet rritje edhe në shërbimet e përdorura, edhe në masat e shqiptuara. Janë përdorur gjithsej 101 shërbime: 56 mbështetje psiko-sociale, 41 ndihmë juridike dhe 4 ndërhyrje me policinë. Janë propozuar 55 masa të përkohshme, prej të cilave 50 janë shqiptuar.

Në vitin 2024 vazhdon trendi i rritjes. Janë propozuar 86 masa të përkohshme pranë Gjykatës themelore në Tetovë, dhe 75 janë shqiptuar. Në të njëjtën periudhë janë përdorur 101 shërbime mbështetëse: mbështetje psikosociale (101 raste), ndihmë juridike (45 raste) dhe ndërhyrje me policinë (10 raste).

Në vitin 2022 në Qendrën oër personat viktimë të dhunës në familje (Strehimore) janë vendosur 3 të rritur dhe 9 fëmijë viktimë. Në vitin 2023 në strehi-

more janë vendosur 10 të rritur dhe 14 fëmijë, përderisa në vitin 2024 në strehi-
more janë vendosur 5 të rritur dhe 8 fëmijë. Në total, gjatë periudhës së viteve
2022-2024, në strehimore janë sistemuar 49 viktimë, prej të cilave 18 të rritur
dhe 31 fëmijë.

2.2 Rastet e regjistruara të dhunës seksuale (2022-2024)

Gjatë periudhës 2022-2024 janë evidentuar gjithsej 11 raste të dhunës seksuale.

Në vitin 2022 janë raportuar 3 raste, prej të cilave një lidhet me trafikim të qe-
nieve njerëzore.

Në vitin 2023 janë regjistruar 2 raste të dhunës seksuale, ku viktimat kanë qenë
të mitur - një djalë dhe një vajzë.

Në vitin 2024 janë evidentuar 6 raste, prej të cilave pesë viktimë kanë qenë va-
jza të mitura, ndërsa një viktimë ka qenë grua e rritur, e cila njëkohësisht është
edhe viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore.

Në total, për viktimat e dhunës seksuale në vitet 2023 dhe 2024, shtatë kanë
qenë gra dhe një mashkull, ndërsa për rastet e vitit 2022 nuk janë siguruar të
dhëna për gjininë. Në asnjë nga rastet e regjistruara nuk është specifikuar mar-
rëdhënia midis viktimës dhe kryerësit, as për dhunën në familje, as për dhunën
seksuale.

3. Gjykata themelore - Tetovë

Sipas të dhënave të siguruara nga Gjykata themelore - Tetovë, në periudhën janar 2022 deri dhjetor të vitit 2024 është evidentuar vetëm një rast me aktgjykim të shpallur për një vepër penale të lidhur me dhunë seksuale.⁴

Bëhet fjalë për një person të rritur të gjinisë mashkullore, me përkatësi etnike maqedonase, ndaj të cilit është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje deri në gjashtë muaj. Rasti lidhet me një vepër të kryer ndaj një viktime me të cilën kryerësi ka pasur lidhje të largët familjare. Nuk është specifikuar viti i saktë i shpalljes së aktgjykimit.

Sa i përket veprave penale lidhur me dhunën në familje, nuk janë dorëzuar të dhëna për persona të dënuar, pasi siç është theksuar nga Gjykata themelore – Tetovë, *për të dhënat e kërkuara lidhur me personat e dënuar për vepra penale të dhunës në familje dhe llojin e procedurës së zhvilluar (kundërvajtëse apo penale), sistemi AKMIS nuk mundëson përpunim automatik të tyre.*

4. Gjykata themelore - Gostivar

Kjo pjesë e raportit përfshin të dhënat e siguruara nga Gjykata themelore - Gostivar, lidhur me rastet e personave të dënuar për vepra penale që lidhen me dhunën në familje gjatë periudhës janar 2022 - dhjetor 2024.

Sipas të dhënave zyrtare të marra nga Gjykata themelore - Gostivar, në periudhën janar 2022 deri dhjetor 2024 janë evidentuar gjithsej **67** raste të personave të dënuar për vepra penale të ndërlidhura me dhunën në familje, të gjitha të trajtuara si procedura penale. Të gjitha rastet janë proceduar në bazë të këtyre neneve të Kodit Penal: Neni 130 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, neni 144 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, dhe neni 123 paragrafët 1, 2 dhe 3.

2022

Totali i
rasteve **22**Kryerës
të dënuar
burra **19**Kryerës të
dënuar gra **3**

2023

Totali i
rasteve **23**Kryerës
të dënuar
burra **21**Kryerës të
dënuar gra **1**

2024

Totali i
rasteve **22**Kryerës
të dënuar
burra **21**Kryerës të
dënuar gra **1**

Tabela 4. Numri i personave të dënuar për vepra penale të lidhura me dhunën në familje në Gjykatën Themelore - Gostivar (2022-2024)⁵

Në lidhje me moshën dhe përkatësinë etnike të viktimave, marrëdhënien midis viktimës dhe kryerësi, si dhe natyrën e sanksioneve të shqiptuara, nga ana e gjykatës nuk janë dorëzuar të dhëna. Gjithashtu, në këtë periudhë trevjeçare (2022-2024) nuk janë evidentuar persona të dënuar për vepra penale të ndërlidhura me dhunën seksuale.

5. Qendra për referim të viktimave të dhunës seksuale - Spitali klinik-Tetovë

Sipas të dhënave zyrtare të siguruara nga Qendra për referim të viktimave të dhunës seksuale pranë Spitalit Klinik - Tetovë, në periudhën **janar 2022 deri dhjetor 2024** janë regjistruar gjithsej **tetë viktima të dhunës seksuale**, me një numër relativisht të qëndrueshëm rastesh të paraqitura përgjatë tre viteve.

Evidenca tregon se shumica e viktimave janë të gjinisë femërore (7 nga 8), ndërsa pesë janë persona të mitur, çka nënvizon seriozitetin e dhunës seksuale ndaj fëmijëve dhe nevojën për ndërhyrje të hershme institucionale. Sa i përket përkatësisë etnike, shtatë viktima i përkasin komunitetit shqiptar, ndërsa një viktimë komunitetit maqedonas.

	2022	2023	2024
Numri i viktimave	2	3	3
Gjinia	Gra	2 Gra dhe 1 burrë	Gra
Mosha	15 vjeç, 40 vjeç	11v. vajzë 13v. vajzë 10v. djalë	7v., 25v., 29v.
Përkatësia etnike	shqiptare	shqiptare	7v. dhe 29v. shqiptare 25v. shqiptare

Tabela 5. Numri i viktimave të dhunës seksuale të regjistruara në Qendrën për referim të viktimave të dhunës seksuale - Spitali klinik-Tetovë (2022-2024)⁶

6. Ministria e punëve të brendshme - Sektori për punë të brendshme- Tetovë

6.1 Të dhënat për gjendjen e dhunës në familje - Sektori për punë të brendshme- Tetovë (2022-2024)

Sipas të dhënave të Ministrisë së punëve të brendshme - Sektori për punë të brendshme Tetovë, në periudhën nga viti 2022- deri në vitin 2024 janë raportuar gjithsej 1.667 raste të dhunës në familje.

Në vitin 2022 janë regjistruar 526 raste, 541 raste në vitin 2023, ndërsa 561 raste në vitin 2024.

	2022	2023	2024
Totali i kallëzimeve kundërvajtëse	15	12	14
Totali i anke-	315	344	330
Totali i veprave penale	153	132	160
Totali i njoftimeve për Prokurorinë themelore publike- Tetovë	53	53	57
Totali i rasteve të raportuara të dhunës në familje	526	541	561

Tabela 6. Numri total i rasteve të raportuara të dhunës në familje (ankesa, kallëzime kundërvajtëse, kallëzime penale dhe njoftime) në Sektorin për punë të brendshme-Tetovë (2022-2024)⁷

Nëse analizohet lëvizja e numrit të rasteve të raportuara gjatë periudhës nga viti 2022 deri në vitin 2024, vërehet një rritje e vazhdueshme. Nga viti 2022 në vitin 2023 numri i rasteve është rritur me 2.85%, ndërsa nga viti 2023 në 2024 me 3.70%. Në total, gjatë tre viteve është regjistruar një rritje prej 6.65%, që tregon një rritje graduale të raportimit të rasteve të dhunës në familje.

	2022	2023	2024
Numri i kallëzimeve	15	12	14
Numri i kryerësve	15	12	14
Kryerës burra	15	12	12
Kryerës gra	0	0	0

Tabela 7. Kallëzimet kundërvajtëse për dhunë në familje në Sektorin për punë të brendshme- Tetovë (2022-2024)

	2022	2023	2024
Totali i ankesave	315	344	330
Dhunë fizike	46	109	41
Dhunë psikologjike	253	218	258
Dhunë ekonomike	16	17	31

Tabela 8. Ankesat për dhunë në familje sipas llojit të keqtrajtimit në Sektorin për punë të brendshme- Tetovë (2022-2024)

	2022	2023	2024
Totali i veprave penale	153	132	160
Totali i kryerësve	169	131	161
Kryerës burra	148	122	142
Kryerës gra	21	9	7
Totali i viktimave	170	130	163
Viktima gra	133	106	127
Viktima burra	37	24	36

Tabela 9. Veprat penale të regjistruara, kryerësit dhe viktimat e dhunës në familje në Sektorin për punë të brendshme- Tetovë (2022-2024)

Në vitin 2022, nga Sektori për punë të brendshme- Tetovë janë dorëzuar **43 njoftime** në Prokurorinë themelore publike për veprat penale **“Lëndim i lehtë trupor”** dhe **“Rrezikim i sigurisë”** në kontekst të dhunës në familje. Në vitin 2023 për të njëjtat dy vepra janë dorëzuar **53 njoftime**, ndërsa në vitin 2024 - **57 njoftime**.

6.2 Veprat penale lidhur me dhunën në familje - viti 2022

Në grupin e veprave penale të lidhura me dhunën në familje, gjatë vitit 2022 janë regjistruar gjithsej 153 raste, të ndara sipas veprave penale si më poshtë:

- 2 raste "Vrasje gjatë dhunës në familje" (Tetovë- 1, Gostivar-1);
- 44 raste "Cenim i sigurisë" (Tetovë- 28, Gostivar-16);
- 99 raste "Lëndim trupor gjatë dhunës në familje" (Tetovë-60, Gostivar-39);
- 2 raste "Lëndim i rëndë trupor gjatë dhunës në familje" (Tetovë- 2);
- 1 rast "Detyrim gjatë dhunës në familje" (Tetovë-1);
- 3 raste "Braktisje e fëmijës së mitur" (Tetovë - 3);
- 2 raste "Kërcënim me mjet të rrezikshëm gjatë përleshjes ose grindjes" (Tetovë- 2).

Sa i përket profilit të kryerësve, në shumicën e rasteve dhunuesit janë burra-gjithsej 148 persona, prej të cilëve:

72 bashkëshortë, 9 baballarë, 27 djem, 12 bashkëshortë jashtëmartesor, 3 ish-bashkëshortë dhe 25 persona të tjerë në lidhje familjare (vëlla, vjehërr, kunat, xhaxha, gjysh etj.).

Si kryerës janë evidentuar edhe 21 gra, prej të cilave: 5 bashkëshorte, 3 vajza, 6 nëna dhe 7 persona në lidhje të tjera familjare (vjehërrë, nuse, kunatë etj.). Gjatë të njëjtës periudhë janë regjistruar 170 viktima të dhunës në familje, prej të cilave 133 janë gra dhe 37 janë burra.

Ndër viktimat gra: 72 kanë qenë bashkëshorte, 20 nëna, 5 vajza, 12 bashkëshorte jashtëmartesore dhe 24 persona në lidhje të tjera familjare (kunatë, vjehërrë, motër, nuse, zollva etj.).

Ndër viktimat burra: 5 kanë qenë bashkëshortë, 14 baballarë, 6 djem dhe 12 persona në lidhje të tjera familjare (kunat, nip, vëlla etj.). Numri më i madh i rasteve të raportuara i përket kryerësve dhe viktimave madhore, të cilët, sipas përkatësisë etnike, i takojnë komunitetit shqiptar, maqedonas, turke dhe rom.

6.3 Veprat penale lidhur me dhunën në familje - viti 2023

Në grupin e veprave penale të lidhura me dhunën në familje, gjatë vitit 2023 janë regjistruar gjithsej **132 raste** (Tetovë- 72, Gostivar- 60), të ndara sipas veprave penale si vijon:

- **53 vepra "Cenim i sigurisë"** (Tetovë - 33, Gostivar - 20);
- **75 vepra "Lëndim trupor gjatë dhunës në familje"** (Tetovë - 38, Gostivar - 37);
- **1 vepër "Lëndim i rëndë trupor gjatë dhunës në familje"** (Gostivar);
- **1 vepër "Privim i kundërligjshëm nga liria"** (Gostivar);
- **1 vepër "Braktisje e fëmijës së mitur"** (Tetovë);
- **1 vepër "Kënaqja e epsheve seksuale para tjetrit"** (Gostivar).

Sa i përket profilin të kryerësve, shumica janë **burra gjithsej 122 persona**, prej të cilëve:

56 bashkëshortë, 4 baballarë, 23 djem, 18 bashkëshortë jashtëmartesor, 5 ish-bashkëshortë dhe 16 persona në lidhje të tjera familjare (vëlla, vjehërr, kunat, xhaxha, gjysh etj.). Janë evidentuar edhe **9 gra** si kryerës të dhunës, prej të cilave: **2 bashkëshorte, 1 nënë, 1 ish-bashkëshorte dhe 5 persona në lidhje të tjera familjare** (vjehërrë, nuse, kunatë etj.).

Gjatë vitit 2023 janë regjistruar gjithsej **130 viktimat**, prej të cilave **106 janë gra** dhe **24 janë burra**.

Ndër viktimat **gra**, shumica janë: **(56) bashkëshorte, (7) nëna, (2) vajza, (18) bashkëshorte jashtëmartesore, (5) ish-bashkëshorte dhe 18 persona në lidhje të tjera familjare** (kunatë, vjehërrë, motër, nuse, rejë etj.).

Ndër viktimat **burra** janë evidentuar: **2 bashkëshortë, 15 baballarë, 3 djem, 1 ish-bashkëshort dhe 3 persona në lidhje të tjera familjare** (kunat, nip, vëlla etj.). Shumica e rasteve të raportuara i përkasin personave madhorë, ndërsa sipas përkatësisë etnike, si kryerësit ashtu edhe viktimat kryesisht i takojnë **komuniteteve shqiptare, maqedonase, turke dhe rome**.

6.4 Veprat penale lidhur me dhunën në familje - viti 2024

Në kuadër të grupit të veprave penale të lidhura me dhunën në familje, gjatë vitit 2024 janë regjistruar gjithsej 160 vepra penale (Tetovë - 101, Gostivar -59), të ndara sipas kategorive si më poshtë:

- 57 vepra të "Cenim i sigurisë" (Tetovë - 39, Gostivar-18);
- 98 vepra "Lëndim trupor gjatë dhunës në familje" (Tetovë- 59, Gostivar-39);
- 1 vepër e "Lëndim i rëndë trupor gjatë dhunës në familje" (Tetovë-1);
- 3 vepra "Privim i kundërligjshëm nga liria" (Tetovë-1, Gostivar-2);
- 1 vepër "Kërcënim me mjet të rrezikshëm gjatë përleshjes ose grindjes" (Tetovë- 1).

Sa i përket profilit të kryerësve, shumica janë burra- gjithsej 142 persona, prej të cilëve: 68 bashkëshortë, 12 baballarë, 35 djem, 14 bashkëshortë jashtëmarte-sor, 3 ish-bashkëshortë dhe 8 persona në lidhje të tjera familjare (vëlla, vjehërr, kunat, xhaxha, gjysh etj.). Janë evidentuar gjithashtu 7 gra si kryerës të dhunës, prej të cilave: 2 bashkëshorte, 1 nënë, 1 bashkëshorte jashtëmartesore, 1 vajzë dhe 2 persona në lidhje të tjera familjare (vjehërrë, nuse, kunatë etj.).

Gjatë vitit 2024 janë regjistruar gjithsej 163 viktima të dhunës në familje (Tetovë-101, Gostivar- 62), prej të cilave 127 janë gra dhe 36 janë burra. Ndër viktimat gra: 98 kanë qenë bashkëshorte, 15 nëna, 8 vajza, 14 bashkëshorte jashtëmartesore, 3 ish-bashkëshorte dhe 22 persona në lidhje të tjera familjare (kunatë, vjehërrë, motra, nuse, zollva etj.). Ndër viktimat burra: 2 kanë qenë bashkëshortë, 22 baballarë, 5 djem, 1 bashkëshort jashtëmartesore dhe 6 persona në lidhje të tjera familjare (kunat, nip, vëlla etj.).

6.5 Të dhënat për gjendjen e dhunës seksuale në Sektorin për punë të brendshme-Tetovë (2022-2024)

	2022	2023	2024
Numri i veprave penale të regjistruara	2	11	15

Tabela 10: Numri i rasteve të regjistruara të dhunë seksuale (2022-2024) në Sektorin për punë të brendshme- Tetovë⁸

	Gjithsej raste	Format kryesore të veprave
2022	2	Abuzim seksual i një personi të pafuqishëm; Joshje e një fëmije nën moshën 14 vjeç.
2023	11	Dhunim (përfshirë fëmijë nën moshën 15 vjeçe); Pornografi fëmijërore, Ngacmim seksual
2024	15	Dhunim, Ngacmim seksual, Pornografi fëmijësore, Kënaqje e pasioneve seksuale në publik

Tabela 11: Numri i rasteve të paraqitura në Sektorin për punë të brendshme-Tetovë lidhur me dhunën seksuale sipas vitit dhe formave kryesore

8 Ministria e punëve të brendshme - Sektori për punë të brendshme Tetovë (2022-2024), Shkurt 2025

	2022	2023	2024
Nr. i v.p	2	11	16
Viktimat (gjithsej)	2	11	14
Viktima gra	2	9	13
Viktima burra	0	2	1
Viktimat e mitura	2	9	11
Viktimat madhore	0	2	5
Kryerës (gjithsej)	3	9	20
Kryerës -burra	3	9	18
Kryerës - gra	0	0	0
Përkatësia etnike: viktimat	2 - shqiptarë	4 - shqiptarë 3 - maqedonasë 2 - romë 2 - tjetër	7 - shqiptarë 1 - romë 1 - të panjohur
Përkatësia etnike: kryerës	3 - shqiptarë	10 - shqiptarë 3 - maqedonasë 1 - tjetër	10 - shqiptarë 7 - maqedonasë 1 - tjetër 2- të panjohur

Tabela 12. Analizë e veprave penale lidhur me dhunën seksuale në Sektorin për punë të brendshme- Tetovë (2022-2024)

Gjatë periudhës 2022-2024 në Sektorin për punë të brendshme- Tetovë janë regjistruar gjithsej **29 vepra penale** lidhur me dhunën seksuale.

Numri më i madh i rasteve është evidentuar në vitin **2024 (16 raste)**, që paraqet gati dyfish rritje krahasuar me vitin 2023.

Gjatë tre viteve janë identifikuar **27 viktimë**, prej të cilave **89% janë të gjinisë femërore** dhe **82% janë persona të mitur**, çka tregon për një rrezik serioz të viktimizimit seksual tek fëmijët.

Nga gjithsej **32 kryerës**, **94% janë burra**, kryesisht të përkatësisë etnike shqiptare dhe maqedonase.

Këto të dhëna konfirmojnë praninë e vazhdueshme të dhunës seksuale me bazë gjinore, me një trend të qartë rritjeje gjatë vitit të fundit të periudhës së analizuar.

Tabela 13. Llojet e veprave penale lidhur me dhunën seksuale të regjistruara në Sektorin për punë të brendshme- Tetovë (2022-2024)

	Lloji i veprës penale	Viti	Numri i veprave	Kryerës (gjithsej)	
	Abuzim seksual i person-it të pafuqishëm	2022	1	2 (burra madhorë, shqiptarë)	
	Joshja ose veprim tjetër seksual e një fëmije nën moshën 14 vjeçe	2022	1	1 (burrë, madhor, shqiptar)	
	Sulm seksual dhe përdhunim	2023, 2024	6	6 (burra, madhorë, shqiptarë)	
	Përdhunim i fëmijës nën 15 vjeç	2023, 2024	6	11 (8 burra, madhor, 3 të mitur; shqiptarë, maqedonë, romë)	
	Prodhimi dhe shpërndarja e pornografisë fëmijërore	2023, 2024	5	5 (burra, madhor, shqiptarë dhe të panjohur)	
	Kënaqje e epsheve seksuale para tjetrit	2024	1	1 (burrë-madhor, maqedonas)	
	Ngacmim seksual	2023, 2024	8	8 (djemë- 7 të mitur, 1 i mitur, shqiptar; 2 kryerës, të panjohur)	

	Viktima (gjithsej)	Gjinia dhe mosha e viktimave	Përkatësia etnike (viktima)	
	1	vajzë, e mitur	shqiptare	
	1	vajzë, e mitur	shqiptare	
	6	5 gra (3 madhore, 2 vajza të mitura), 1 burrë	shqiptare, maqedonase	
	6	5 vajza 1 djal (të gjithë të mitur)	shqiptare, maqedonase, ромска	
	6	3 vajza, 2 djemë (të gjithë të mitur)	maqedonase, shqiptare, непозната	
	2	2 gra, madhore	shqiptare	
	8	7 vajza, 1 djal (kryesisht të mitur)	shqiptare, maqedonase	

Gjithsej vepra penale	Gjithsej kryerës	Gjithsej viktima
28	32	29

Tabela 14. Përmbledhje e të dhënave (2022-2024)

Gjatë periudhës së viteve **2022-2024**, sipas të dhënave të marra nga Sektori për punë të brendshme-Tetovë, më së shpeshti paraqiten veprat **“Sulm seksual dhe përdhunim”** dhe **“Përdhunim i fëmijës nën 15 vjeç”**, të cilat së bashku përbëjnë mbi 40% të të gjitha rasteve.

Krahasuar me vitin 2022, në vitin 2024 vërehet një rritje mbi gjashtëfish e numrit të rasteve të regjistruara, si dhe zgjerim i llojeve të veprave - nga dy kategori në vitin 2022, në pesë kategori të ndryshme në vitin 2024.

Shumica e kryerësve janë burra dhe madhor, shumica të përkatësisë **etnike shqiptare dhe maqedonase**, ndërsa viktimat janë kryesisht **vajza të mitura**, çka thekson nevojën për forcimin e masave parandaluese dhe ndërhyrjeve me kohë.

Gjithashtu, vërehet rritje e numrit të rasteve me kryerës të panjohur, veçanërisht tek veprat që lidhen me **ngacmim seksual** dhe pornografi fëmijërore, gjë që tregon për sfida në identifikimin dhe ndjekjen e këtyre veprave penale.

Përfundime

Të dhënat për periudhën 2022-2024 zbulojnë një pamje komplekse dhe shqetësuese për praninë e dhunës në familje dhe dhunës seksuale në rajonin e Pollogut. Analiza tregon se gratë dhe vajzat janë viktimat më të shpeshta të këtyre formave të dhunës, që vërteton bazën gjinore të saj dhe rrënjët e thella në strukturat patriarkale të shoqërisë. Veçanërisht shqetësues është rritja e numrit të vajzave të mitura viktimat të dhunës seksuale, më e shprehur në vitin 2024. Mungesa e të dhënave më të detajuara, si dhe bashkëpunimi i kufizuar ndërinstitucional, e zvogëlojnë efektivitetin e politikave për mbrojtje dhe e vështirësojnë monitorimin e rasteve.

Të dhënat e marra nga Qendra ndërkomunale për punë sociale - Gostivar tregojnë se gjatë periudhës trevjeçare janë regjistruar 92 raste të dhunës në familje, ku të gjitha viktimat kanë qenë gra. Ky fakt konfirmon përhapjen e lartë të viktimizimit me bazë gjinore në këtë rajon. Edhe pse nuk janë evidentuar raste të dhunës seksuale, kjo nuk mund të interpretohet si mungesë e saj, por më së shumti si rezultat i identifikimit të pamjaftueshëm, frikës nga raportimi ose mosbesimit ndaj institucioneve. Mungesa e të dhënave për formën e dhunës, moshën e viktimave dhe llojin e mbështetjes institucionale thekson nevojën për avansimin e sistemit të evidencimit dhe shkëmbimit të informacionit.

Në Qendrën ndërkomunale për punë sociale - Tetovë, me gjithsej 214 raste të regjistruara, vërehet një rritje e konsiderueshme, veçanërisht në vitin 2024 kur numri ka arritur në 101 raste. Forma më e përhapur e dhunës është dhuna psikologjike, e pasuar nga dhuna fizike dhe ajo ekonomike. Evidentohet gjithashtu rritje e rasteve të dhunës seksuale (gjithsej 11), me dominim të viktimave vajza të mitura, çka tregon rrezik të shtuar dhe nevojë për masa më specifike mbrojtëse. Edhe pse sigurohet mbështetje psikosociale dhe juridike, mungojnë të dhëna të sistematizuara për rezultatet e procedurave, gjë që e kufizon pasqyrën e plotë mbi efektivitetin e ndërhyrjeve.

Qendra për referim të viktimave të dhunës seksuale pranë Spitalit Klinik-Tetovë ka evidentuar tetë viktimat gjatë periudhës së analizuar, kryesisht vajza të mitura të përkatësisë etnike shqiptare. Edhe pse numri i rasteve është relativisht i vogël, struktura e tyre tregon për rrezik të lartë tek fëmijët dhe për vulnerabilitet etnik brenda komuniteteve. Nevojitet promovim më intensiv dhe

rritje e aksesit në shërbimet e qendrës, veçanërisht në zonat rurale dhe të marginalizuara, ku viktimat shpesh nuk kanë mundësi për ndihmë adekuate.

Në Gjykatën themelore - Tetovë, gjatë gjithë periudhës së analizuar është evidentuar vetëm një aktgjykim për dhunë seksuale. Këto të dhëna i referohen vështirësive të mundshme në identifikimin dhe procedimin e rasteve të tilla. Gjykata, po ashtu, nuk i dorëzoi informacionet e kërkuara për lëndët që lidhen me dhunën në familje, duke theksuar se sistemi AKMIS nuk mundëson përpunim automatik të të dhënave për personat e dënuar për vepra penale nga kjo kategori. Në krahasim me këtë, Gjykata themelore - Gostivar i dorëzoi informacionet e kërkuara pa vështirësi, gjë që tregon nevojën për më shumë harmonizim në përdorimin e sistemeve teknike dhe në transparencën e praktikës gjyqësore.

Në Gjykatën themelore - Gostivar janë trajtuar 67 raste të dhunës në familje, të gjitha të trajtuara si vepra penale, ku kryerësit kryesisht janë burra. Edhe këtu nuk janë evidentuar raste të dhunës seksuale, gjë që ngre pyetje rreth komunikimit dhe koordinimit me institucionet e tjera. Mungesa e informacionit për sanksionet e shqiptuara dhe marrëdhënien midis kryerësit dhe viktimës e kufizon pasqyrën mbi shkallën e mbrojtjes ligjore.

Regjistrimi më i detajuar sigurohet nga Ministria e punëve të brendshme - Sektori i punëve të brendshme - Tetovë, me 1.667 raste të raportuara të dhunës në familje dhe 28 raste të dhunës seksuale gjatë tre viteve. Vërehet një trend në rritje i dhunës seksuale, veçanërisht ndaj të miturve, si dhe mungesë përputhshmërie midis numrit të rasteve të raportuara në MPB dhe regjistrimeve të institucioneve të tjera. Kjo tregon për mungesë koordinimi, shkëmbim të pamjaftueshëm të informacionit dhe mungesë të një sistemi të unifikuar monitorimi.

Gjatë vitit 2022 janë raportuar 15 kundërvajtje, 315 ankesa dhe 196 vepra penale, prej të cilave 153 kanë rezultuar me kallëzime penale. Në vitin 2023 janë evidentuar 12 kundërvajtjeve, 344 ankesa, dhe vepra penale 185, prej të cilave 132 kanë rezultuar me kallëzime penale. Në vitin 2024 janë regjistruar 14 kundërvajtje, 330 ankesa dhe 218 vepra penale, me 161 kallëzime penale dhe 57 njoftime. Edhe pse numri i rasteve të dhunës në familje shënon një ulje të lehtë në vitin 2024 krahasuar me vitin paraprak, Sektori për punë të brendshme-Tetovë mbetet institucioni me numrin më të madh të rasteve të regjistruara në rajon. Analiza e përgjithshme tregon se dhuna në familje dhe dhuna seksuale në ra-

jonin e Pollogut përbëjnë një problem të strukturuar dhe ndërsektorial me implikime të thella sociale dhe institucionale. Rastet e dhunës seksuale, edhe pse në numër më të vogël, tregojnë një trend në rritje, veçanërisht në vitet 2023 dhe 2024, me dominim të viktimave të mitura. Identifikimi i pamjaftueshëm i këtyre rasteve në disa institucione, siç është Qendra ndërkomunale për punë sociale në Gostivar, tregon për nevojën e monitorimit të përforcuar dhe bashkëpunimit ndërsektorial.

Në përgjithësi, këto gjetje tregojnë se dhuna ndaj grave dhe fëmijëve, veçanërisht dhuna seksuale ndaj të miturve, nuk duhet të mbetet një çështje e marginalizuar. Nevojitet njohje sistematike e këtij fenomeni si një çështje e sigurisë publike, e të drejtave të njeriut dhe e drejtësisë sociale. Pa ndërhyrje të integruara, të shpejta dhe të koordinuara, ekziston një rrezik real për normalizimin e mëtejshëm si dhe thellimin e ciklit të dhunës. Ky raport përbën një thirrje për të gjitha institucionet relevante, autoritetet lokale dhe sektorin qytetar për të forcuar bashkëpunimin, rritur llogaridhënien dhe ndërtuar një sistem funksional mbrojtjeje, ku në qendër do të jetë viktimat dhe siguria e saj.

Rekomandimet

Bazuar në përfundimet e analizës për periudhën 2022-2024, propozohen masat e mëposhtme institucionale dhe ndërsektoriale, të drejtuara për tejkalimin e dobësive dhe boshllëqeve të identifikuara në sistemin e mbrojtjes:

1. Forcimi i sistemit të evidencës dhe raportimit statistik

Institucionet: Sektori për punë të brendshme-Tetovë, Qendra ndërkomunale për punë sociale në Tetovë dhe Qendra ndërkomunale për punë sociale në Gostivar, si dhe Gjykatat themelore duhet të krijojnë një bazë të vetme elektronike të të dhënave për rastet e dhunës në familje dhe dhunës seksuale, ku rregullisht do të regjistrohen të dhënata sipas gjinisë, moshës dhe përkatësisë etnike. Kjo do të mundësojë analizë të hershme, krahasim dhe koordinim midis institucioneve, si dhe njëkohësisht do të përmirësojë transparencën dhe llogaridhënien e punës së tyre.

2. Koordinim ndërinstitutional dhe shkëmbim informacioni

Të krijohen takime koordinuese të rregullta midis Sektorit për punë të brendshme-Tetovë, Qendra ndërkomunale për punë sociale, Gjykatave dhe Spitalit klinik - Tetovë, për shqyrtimin e përbashkët të rasteve me rrezik të lartë. Të formohen ekipe operative për ndërhyrje urgjente, të cilat do të shkëmbejnë të dhëna në kohë reale dhe do të veprojnë të koordinuar në rastet emergjente të dhunës në familje dhe dhunës seksuale.

3. Identifikimi i hershëm dhe mbrojtja e fëmijëve

Qendra ndërkomunale për punë sociale - Tetovë dhe Qendra ndërkomunale për punë sociale - Gostivar, në bashkëpunim me shkollat dhe policinë, duhet të vendosin protokolle të standardizuara për identifikimin dhe raportimin e hershëm të dhunës ndaj fëmijëve. Të sigurohen psikologë dhe pedagogë në çdo shkollë të madhe në Tetovë dhe Gostivar, me detyrimin për të mbajtur evidencë dhe për të raportuar rastet e dyshimta. Qendra për Referimin e Viktimave të dhunës Seksuale pranë Spitalit Klinik në Tetovë duhet të krijojë ekipe mobile për zonat rurale, me qëllim rritjen e aksesit në shërbime dhe ndërhyrje të hershme.

4.Përforcimi i kapaciteteve të institucioneve

Sektori për punë të brendshme-Tetovë, Qendra ndërkomunale për punë sociale dhe Spitali klinik -Tetovë duhet të zhvillojnë trajnime të rregullta për stafin në fushën e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës seksuale, me theks të veçantë në punën me viktimat, evidentimin dhe vlerësimin e rrezikut.

Duhet të sigurohet rritje e kapaciteteve të qendrave për akomodim në rast krize në rajonin e Pollogut, pasi qendra ekzistuese e strehimit në Gostivar ka kushte të kufizuara për akomodim afatgjatë.

5.Përmirësimi i praktikës gjyqësore dhe qasjes në drejtësi

Gjykata themelore në Tetovë dhe Gjykata themelore në Gostivar duhet të krijojnë një evidentim të brendshëm për rastet e dhunës në familje dhe dhunës seksuale, me të dhëna të veçanta për llojin e veprës, sanksionin dhe marrëdhënien kryerës-viktimë. Nevojitet të inkurajohet transparencë më e madhe në raportimin gjyqësor dhe publikimi i rregullt i të dhënave të përmbledhura, me qëllim analize më të mirë të praktikës gjyqësore.

6.Promovimi dhe aksesueshmëria e shërbimeve për viktimat

Qendra ndërkomunale për punë sociale në Tetovë dhe Gostivar, në bashkëpunim me Sektorin për punë të brendshme-Tetovë, duhet të zhvillojnë fushata lokale informuese përmes mediave, shkollave dhe rrjeteve sociale, për të informuar qytetarët mbi mënyrat e raportimit dhe shërbimet në dispozicion. Duhet të krijohen pika këshillimi dhe ndihme e parë psikosociale brenda qendrave shëndetësore në zonat rurale.

7.Strategji lokale dhe llogaridhënie

Institucionet në rajonin e Pollogut duhet të hartojnë së bashku një Strategji lokale për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna seksuale (2025-2030), me qëllime të definuara qartë, tregues dhe mekanizma monitorimi. Duhet të vendoset një raportim i rregullt për Këshillat e komunave në Tetovë dhe Gostivar mbi zbatimin e strategjisë dhe progresin në reagimin institucional.

8. Forcimi i rolit të organizatave qytetare dhe partneriteti me institucionet

Duhet të forcohet roli i organizatave joqeveritare që punojnë në fushën e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, përmes bashkëpunimit të institucionalizuar dhe koordinimit të rregullt me institucionet publike. Komunitetet e Tetovës dhe Gostivarit, në koordinim me Qendrat ndërkomunale për punë sociale, duhet të vendosin një mekanizëm partneriteti me sektorin qytetar, i cili do të mundësojë: aktivitete të përbashkëta në terren për identifikimin dhe mbështetjen e viktimave, pjesëmarrje të përfaqësuesve të OJQ-ve në ekipe multidisiplinare, mbështetje financiare dhe logjistike për sigurimin e shërbimeve psikosociale, juridike dhe këshilluese, si dhe shkëmbim të vazhdueshëm të informacioneve dhe praktikave të mira midis institucioneve dhe organizatave qytetare. Kjo qasje do të sigurojë efektivitet më të madh dhe besim në sistemin e mbrojtjes, veçanërisht në fushën e parandalimit, identifikimit të hershëm dhe rehabilitimit afatgjatë të viktimave.

